

# Tako Zotin

## «A do të shërohesh me të vërtetë?»

(Gjoni 5:1–16)

Në kapitullin 5 tek Ungjilli i Gjonit, Jezusi bën një pyetje të çuditshme. Jezusi i afrohet një të sëmuri dhe e pyet: «A dëshiron të shërohesh»? (v. 6). Rreshti 5 shpjegon se ky njeri ka qenë i sëmurë prej 38 vjetësh dhe Jezusi e pyeti n.q.s. ai me të vërtetë donte të shërohej!

Kjo pyetje është e njëjtë me pyetjet që ne bëjmë sot. Një njeri i afrohet një makine që ka pësuar aksident dhe duket pothuajse e shkatërruar. Brenda në makinë ndodhet një njeri në gjendje shumë të keqe. Gjaku i rrjedh nga të çarat në kokë dhe gjymtyrët e trupit nuk i përgjigjen. Njeriu pyet: «A është çdo gjë në rregull»? Një burrë shkon në spital të vizitojë një shokun e tij. Shoku i tij është i fashuar nga koka te këmbët dhe fytyra e tij është gati e deformuar nga dhembjet. Tuba të panumërt janë lidhur në trupin e tij. Burri pyet: «A ke dhembje?»

Për ta bërë ilustrimin më personal: Supozo se ti nuk ndihesh mirë gjithë kohën dhe dikush të pyet: «A do të të pëlqente të ndiheshe më mirë»? Ose mendo se dikush përmend emrin e një njeriu me të cilin ke pasur mosmarrëveshje për një kohë të gjatë dhe të pyet: «a do të doje të miqësoheshe me atë person»? Po, n.q.s. ti ke probleme me martesën apo familjen tënde dhe dikush të pyet: «A do të doje të kishe një martesë më të lumtur apo më shumë paqe dhe qetësi në familjen tënde»? Nëse ti ndihesh shumë fajtor për diçka dhe dikush vjen dhe të pyet: «A do të doje të çliroheshe nga faji yt?»

Reagimi yt i parë do të jetë: «Çfarë pyetje qesharake! Natyrisht unë dua të shërohem (apo të miqësohem me njerëzit, të kem martesë të lumtur dhe paqe në familje apo të çlirohem nga faji). Është e çuditshme që ti, madje, e bën këtë pyetje!» Të gjithë ne i duam këto gjëra! ... Apo jo?

Mbaji mend këto pyetje ndërkohë që studjojmë Gjoni 5:1–16.

Jezusi kishte filluar misionin e Tij në Galile. Një tipar i këtij misioni ishte shërimi i të sëmurit. Ndërsa Jezusi i mësonte dhe i shëronte njerëzit, dy gjëra ndodhën: (1) Turma filloi të rritej dhe (2) kundërshtimi rritej. Në këtë mësim do të studiojmë një rast shërimi dhe do të shikojmë kundërshtimet që pasojnë si rezultat. Ndërsa studiojmë këtë ngjarje, ne duam të analizojmë pyetjen e çuditshme që bëri Jezusi: «A dëshiron të shërohesh?»

### JEZUSI SHËROI NJË NJERI AFËR NJË PELLGU

Në fillim le të shikojmë se si Jezusi shëroi një njeri në pellgun e Betesdës. Unë do të sugjeroja që ky ishte një shërim me tre procese.

#### Shërimi i trupit (Gjoni 5:1–6)

Kapitulli 5 fillon: «Pas këtyre ngjarjeve ishte një festë e Judenjve dhe Jezusi u ngjit në Jeruzalem» (v. 1). Meqënëse ishte «një festë» dhe jo «festa», kjo mund t'i referohet njëres prej festave të vogla të hebrenjve në të cilën burrat hebrenj

nuk ishin të detyruar të shkonin. Jezusi shfrytëzonte çdo mundësi për të adhuruar<sup>1</sup> dhe jo si disa sot që shkojnë në shërbesat në kishë vetëm kur «janë të detyruar»!

«Në Jeruzalem, afër *portës* së dhenve, është një pellg që në hebraisht quhet Betesda dhe ka pesë portikë» (v. 2). Fjala «portë» është me shkronja të pjerrëta, sepse është shtuar nga përkthyesit. Teksti origjinal thotë «afër dhenve». Ndoshta kjo i referohet portës së dhenve, nga ku dhentë kalonin për t'u bërë kurban.

Pellgu i përmendur këtu ekziston akoma edhe kësaj dite. «Betesda» ndoshta do të thotë «shtëpia e mëshirës». «Pesë portikët» ishte një vend i mbuluar përreth pellgut.

Skena që do të përshkuajmë tani të prek në zemër: «Nën to (portikët) dergjeshin një numër i madh të lënguarish: të verbër, të çalë dhe të paralizuar» (v. 3). Era e keqe të shponte hundët. Zërat lëngues të të sëmurëve, gjendja e tyre e tmerrshme dhe era e keqe do të sëmurte çdo njeri që do të afrohej.

Më pas kemi këto vargje në Bibël:

... të cilët prisnin lëvizjen e ujit. Sepse një engjëll, kohë pas kohe zbriste në pellg dhe e lëvizte ujin dhe i pari që hynte, mbasi uji ishte lëvizur, shërohej nga çfarëdo sëmundje që të kishte (vargjet 3b, v. 4).

Ky shpjegim nuk ishte në tekstin origjinal, por është gjetur në një libër komentesh nga një shkrimtar i lashtë dhe është përfshirë në tekst. Këto vargje tregojnë për një supersticion të vjetër që sillte njerëzit në atë vend (lexoni v. 7). Ky pellg që është quajtur Betesda, furnizohej me ujë nga burime nëntokësore. Herë pas here uji do të ngrihej lart si shatërvan. Dhe njerëzit mendonin se një engjëll po e trazonte ujin.

«Aty ishte një njeri që lëngonte prej tridhjetë e tetë vjetësh» (v. 5). Ne mund të themi me siguri se ky njeri kishte qenë i sëmurë gati gjithë jetën e tij. Sipas vargut 7, ai s'mund të lëvizte, ai nuk mund të shkonte vetë te pellgu. Ai ishte ose shumë i dobët, ose shumë i paralizuar, ose shumë i kërrusur. Ky është vargu 6: «Jezusi, duke e parë shtrirë dhe duke ditur se prej shumë kohe ishte në atë gjendje, i tha: “A dëshiron të shërohesh?”»? Jezusi kishte ardhur me qëllim te pellgu ku të sëmurët mblidheshin. Natyrisht Jezusi nuk kishte

shkuar për të vizituar qytetin. Pa dyshim dhemshuria që Ai kishte për këta njerëz, e kishte motivuar për të vizituar qytetin. Kur Jezusi arriti te pellgu, Ai pa njeriun që ishte i sëmurë për tridhjetë e tetë vjet. Pse Jezusi vendosi ta shërojë atë njeri? Nga të gjithë njerëzit rreth e rrotull pellgut, Jezusi vendosi të shërojë vetëm një. A ndodhi kjo, sepse ky ishte një rast shumë i vështirë sëmundjeje që mund të shërohej vetëm me anë të një mrekullie? A ndodhi, sepse ky njeri ishte pa shpresa dhe Jezusi ishte shpresa për të gjithë të pashpresët? Apo ndoshta ky njeri nuk kishte miq (v. 7) dhe Jezusi ishte miku më i mirë për ata që s'kishin miq?

Cilado qoftë arsyeja, Jezusi i afrohet të sëmurit, duke ditur se ai «kishte qenë për një kohë të gjatë në ato kushte» (për tridhjetë e tetë vjet) dhe e pyet: «A dëshiron të shërohesh?»

Le ta diskutojmë pak këtë pyetje. Pse Jezusi bën një pyetje kaq të çuditshme?

Mendo pak për të: Është e vështirë të jesh sëmurë për tridhjetë e tetë vjet, por në një anë ai kishte një jetë të lehtë. Dikush e sillte atë në pellg çdo ditë. Ai qëndronte atje gjithë ditën pa prekur gjë me dorë! Ndoshta ai ishte në gjendje që gjatë ditës të grumbullonte ndonjë ndihmë nga njerëzit e tjerë. Dikush tjetër kujdesej për të. Ndoshta ai i ishte dorëzuar fatit të tij, i ishte nënshtruar të pashmangshmes. Gjithë jeta e tij do të kalonte në atë mënyrë, s'kishte zgjidhje tjetër.

Por, po sikur ai të shërohej menjëherë? Ai do të ballafaqohej me barrën e punës për të siguruar bukën e përditshme. Atij do t'i duhej të vendoste vetë për jetën e tij. Ndoshta ai duhet të përgatitej për të përballuar dështimin që mund t'i ndodhte.

Jezusi po pyeste: «Me gjithë mend dëshiron të shërohesh? A je gati të pranosh rezultatet e të shëruarit?»

Disa njerëz përfitojnë nga të qenit sëmurë. A e keni dëgjuar atë thënie e vjetër se disa njerëzve «u pëlqen të sëmuren?». Disave u pëlqen që t'i kenë gjërat gati, të tjerëve u pëlqen kujdesi që u jepet. Disa të tjerë e përdorin sëmundjen si një shfajësim për të mos bërë çfarë duhet të bëjnë. Ka nga ata që e përdorin sëmundjen për të përfituar dhe kontrolluar të tjerët.

Pyetja e Jezusit nuk është aq e çuditshme sa duket.

## Shërimi i mendjes (Gjoni 5:7–13)

Le të studiojmë më tej pyetjen. Jezusi i njihte të gjithë njerëzit, Ai e dinte çfarë mendonin ata (Gjoni 2:25). Pra, Jezusi nuk e bënte pyetjen që të zbulonte përgjigjen. Por, përkundrazi, Ai e bënte pyetjen, me qëllim që ky i sëmurë të reflektonte. Jezusi nuk ishte i shqetësuar vetëm për shërimin e trupit. Ai gjithashtu ishte i preokupuar për shërimin e mendjes. Ai dëshironte që ky person të zhvillonte dhe përmirësonte të menduarin e tij.

Ky njeri e kuptoi pyetjen e Jezusit si një qortim. Ai e kuptoi pyetjen në këtë mënyrë: «N.q.s. do të shërohesh, pse nuk lëviz? Kur uji është e turbulluar, pse nuk nxiton që të hidhesh brenda i pari»? «I sëmuri u përgjigj: “Zot, unë s’kam njeri që, kur lëviz uji, të më fusë në pellg dhe, ndërsa unë shkoj, një tjetër zbret para meje”» (v. 7).<sup>2</sup>

Ky pellg është shumë i thellë. Menjëherë sa futesh në të, takon thellësinë. Një njeri që s’është në gjendje të ecë duhet të ndihmohet nga dikush për të zbritur në pellg. Kur uji lëvizte, çdo njeri mendonte për kokën e tij, kështu që ky i sëmurë s’kishte ndonjë mundësi për t’u futur në ujë.

Ky njeri në vend që t’i përgjigjej «po» apo «jo» pyetjes së Jezusit, po thoshte: «Nuk është faji im që jam i sëmurë! Unë nuk kam ndonjë njeri që të më ndihmojë!» Kur kemi probleme, nuk është asnjëherë faji ynë, apo jo? Shpesh ne mendojmë se dikush tjetër e ka fajin. Ndoshta, si i sëmuri, ne gjithashtu kemi nevojë për të ndryshuar mënyrën se si mendojmë.

Jezusi s’mbaroi punë menjëherë me atë njeri. Ai donte të bënte një shërim të plotë të tij: shërimin e mendjes dhe shërimin e trupit në të njëjtën kohë. «Jezusi i tha: “Çohu, merr vigun tënd dhe ec”» (v. 8). Për tridhjetë e tetë vjet ai krevat e mbajti të sëmurin, tani ai duhet të mbante krevatin.

Prit një minutë. Kjo është pikërisht ajo që njeriu tha se nuk do të bënte! N.q.s. ai do të ishte në gjendje të ecte ai do të futej në ujë i pari. Madje, n.q.s. njeriu s’do të kishte qenë i sëmurë, s’kishte pse të shkonte te pellgu. Jezusi i kërkoi njeriut të bënte të pamundurën. Ai e pyeti: «A do të shërohesh kaq mirë sa të jesh në gjendje të ecësh»?

Diçka te Jezusi tërhoqi vëmendjen e të sëmurit. Nuk është se i sëmuri e njihte Jezusin apo kishte besim tek Ai. Siç do të shikojmë në vargun 13, i

sëmuri nuk e kishte idenë se kush ishte Jezusi. Por, ai vendosi që ta provonte atë që Jezusi kërkoi. «Njeriu u shërua në çast, mori vigun e tij dhe eci» (v. 9a). Si të gjitha shërimet e Jezusit ky ishte i menjëhershëm, i tërësishëm dhe (siç do të shikojmë) bindës.

Unë jam aksidentuar disa herë gjatë jetës sime. Disa prej tyre më kanë detyruar që për një kohë të caktuar të qëndroja në shtrat pa qenë në gjendje të lëvizë. Unë e kuptoj shumë mirë se duke qëndruar në shtrat për një kohë të gjatë muskujt dobësohen, dhimbjet të pushtojnë të gjithë trupin dhe ti nuk mund të ecësh dot edhe pse do të doje aq shumë. Imagjinoni çfarë kishte bërë sëmundja për tridhjetë e tetë vjet në trupin e këtij njeriu. Kur Jezusi e shëroi atë, kalimtarët mund të kenë parë trupin e tij të *mbushej* dhe të drejtohej përsëri!

**Cilido qoftë problemi  
juaj, Jezusi mund t’ju  
ndihmojë, n.q.s. ju do t’i  
jepeni Atij dhe n.q.s. ju  
jeni gati të paguani  
çmimin që kërkohet.**

Gjoni shton në shkrimin e tij: «Ajo ditë ishte e shtunë» (v. 9b). A e shëroi Jezusi të sëmurin të shtunën për të shkaktuar konflikt me armiqtë e Tij? Ndoshta po. Në një rast tjetër Ai veproi në të njëjtën mënyrë (Mateu 12:1–14). A ishte thjesht rastësi që Jezusi shëronte të shtunave? Ndoshta ishte. Pavarësisht se ishte me paramendim apo jo, Gjoni do që ne të dimë se ishte dita e shtune, sepse kjo shpjegon çfarë vijon më poshtë.

Imagjinoni gëzimin rreth e rrotull pellgut kur i sëmuri u ngrit dhe eci! Sidoqoftë, disa njerëz të tjerë të pranishëm, siç ishin farisenjtë, udhëheqësit fetarë dhe mbrojtësit e traditave, nuk u gëzuan. Ata nuk e vunë në dyshim mrekullinë, por ishin të shqetësuar për një nga rregullat që ata vetë kishin krijuar. «Prandaj hebrenjtë i thanë atij që u shërua: “Është e shtunë<sup>3</sup>, nuk është e ligjshme për ty të ngresh vigun tënd”»! (v. 10). A nuk është kjo e

trishtueshme? Ata nuk e përmendën fare shërimin. A ishin të pakënaqur që njeriu ishte shëruar? Ata thanë: «Ti ke thyer një nga traditat tona!»

Fjala «e shtunë» në gjuhën origjinale (hebraisht) do të thotë pushim. Perëndia pushoi në ditën e shtatë pasi, krijoi botën (Zanafilla 2:1–3). Më vonë, dita e shtatë e pushimit ishte përfshirë në Dhjetë Urdhërimet (Eksodi 20:8–11). E shtuna ishte një ditë e veçantë për hebrejtë. Ishte një ditë pushimi, një ditë adhurimi dhe një kohë kur njerëzit mendonin për Perëndinë dhe gëzoheshin për Të. Për t’u siguruar se e shtuna respektohej, Perëndia vendosi ndëshkime shumë të rënda për këdo që thyente rregullat. Tek kapitulli 15 i Numrave një njeri u godit me gurë deri në vdekje, sepse mbloodhi dru ditën e shtunë. Në librin e Nehemisë, ndëshkim i rëndë priste këdo që bënte tregti të shtunave.

Ligjet e Perëndisë ishin mjaft të rrepta, por prapëseprapë farisenjtë nuk rrinin dot pa shtuar diçka. Farisenjtë e zgjeruan ligjin e së shtunës duke i shtuar njëzet e tre kapituj me rregulla! Shumë nga këto rregulla ishin qesharake. Për shembull, ekzistonte një rregull sipas të cilit prerja e thonjve ditën e shtunë ishte e ndaluar, sepse kjo konsiderohej punë. Shumë nga rregullat e krijuara nga farisenjtë për ditën e shtunë kishin të bënin me ngarkesën që një njeri mund të mbante. Mësuesit e ligjit ndalonin njerëzit të vinin proteza ose të ecnin me paterica, meqënëse këto ishin konsideroheshin si ngarkesë për mbartësin e tyre. N.q.s një grua pasi kishte qepur apo arnuar një rrobë do të harronte aksidentalisht gjilpërën në të dhe nëse burri i saj do ta vishte atë rrobë, atëhere ai mëkatonte, sepse në këtë mënyrë ai do të mbartte gjilpërën. (Këto kufizime nuk ishin kufizime të vendosura nga Zoti, por ishin kufizime të vendosura nga njerëzit.)

Një nga këto rregulla lidhet drejtpërdrejt me situatën në kapitullin e pestë të Gjonit. Sipas mësuesve të ligjit, një njeri mund të mbarte një krevat me një njeri mbi të, sepse, sipas tyre, «krevati ishte i parëndësishëm», por ky njeri s’mund të mbartte një krevat pa njeri mbi të. Por kjo ishte pikërisht ajo çfarë Jezusi i kishte thënë të sëmurit të bënte: «Çohu, merr vigun [domethënë krevatin] tënd dhe ec».

Kur farisenjtë thanë: «Është e shtunë, nuk është e ligjshme për ty të ngresh vigun tënd»,

njeriu në fakt tha: «Nuk është faji im». (Ai i kishte thënë më parë Jezusit: «Nuk është faji im që unë nuk eci dot». Tani po u thotë farisenjve: «Nuk është faji im që unë eci».) «Por ai i’u përgjigj atyre: “Ai që më shëroi mua ishte ai që më tha: «Çohu, merr vigun tënd dhe ec»”» (v. 11). Me fjalë të tjera: «n.q.s. ky njeri ka autoritetin të më shërojë, natyrisht Ai ka autoritetin të më kërkojë të mbart vigun tim»!

Ata e pyetën: «Kush është ai që të tha: “Çohu, merr vigun tënd dhe ec»? Por i shëruari nuk e kishte idenë se kush ishte, sepse Jezusi ishte larguar për shkak të turmës që ishte në atë vend (vargjet 12, 13). Vëreni faktin e shprehur më parë: Njeriu se kishte idenë se kush ishte Jezusi. Jezusi, pasi e kishte shëruar, kishte ikur përmes turmës.

### **Shërimi i shpirtit (Gjoni 5:14–16)**

Jezusi s’kishte mbaruar punë me atë njeri. «Më vonë Jezusi e gjeti në tempull [natyrisht ish i sëmuri ishte aty të lavdëronte Zotin për shërimin e tij] dhe i tha: “Ja, ti u shërove; mos mëkato më që të mos të të bëhet një gjë më e keqe”» (v. 14). «Më e keqja» që Jezusi përmend, ndoshta i referohet një sëmundjeje më të keqe apo ndoshta i referohet ferrit.

Shumë studiues mendojnë që fjalët e Jezusit tregojnë se sëmundja e njeriut ishte rezultat i mëkatit në jetën e tij. Kjo është e mundur. Tek Gjoni kapitulli 9 Jezusi thekson se jo e *gjithë* sëmundja është rezultat i mëkatit personal. Sidoqoftë, *disa* sëmundje janë të lidhura me mëkatin personal si p.sh. SIDA. Jo çdo njeri që ka virusin HIV (virusi i Sidës) ka mëkatuar, por shumica e atyre që kanë këtë virus, e kanë për shkak të mëkatit seksual.

Gjithashtu ka mundësi të mos ketë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë midis mëkatit në jetën e dikujt dhe shëndetit të tij. Ndoshta Jezusi dëshiron të shërojë më parë mëkatin *më të madh*. Gjëja e parë në listën e Jezusit ishte gjithmonë shërimi e shpirtit dhe jo i trupit. (Një shoku im mendon se, kur Jezusi tha: «Mos mëkato më», Ai donte të thoshte që ish i sëmuri që ishte i paralizuar për 38 vjet s’kishte patur mundësi që të bënte ndonjë gjë dhe tani që mund të ecte, do të ishte i tunduar të bënte gjithë gjërat që s’mund t’i bënte më parë!)

Cilido që të ketë qenë kuptimi i fjalëve të

Jezusit «mos mëkato më», një e vërtetë është e qartë: Preokupimi i parë i Jezusit ishte për gjendjen shpirtërore të të sëmurit. N.q.s. trupi i ish të sëmurit do të shërohej, por marrëdhëniet e tij me Perëndinë s’do të përmirësoheshin, atëhere shërimi fizik s’do të kishte shumë vlerë. Jezusi ishte i interesuar për trupin e njeriut, për mendjen e tij dhe, mbi të gjitha, për shpirtin e atij njeriu.

Vargu 15 fillon të mbyllë këtë ngjarje: «Njeriu u largua dhe u tregoi hebrenjve se Jezusi e kishte shëruar atë». Ky njeri ndoshta filloi t’i informojë hebrenjtë duke u përgjigjur pyetjeve që ata i bënin: «*Kush ... të tha ty, “Merre vigun tënd dhe ec”*»? (v. 12). Megjithatë unë mendoj se ai s’e bëri këtë gjë. Vëreni dëshminë e tij. Ai nuk tha se ishte Jezusi Ai që i tregoi të merrte vigun dhe të ecte. Përkundrazi ai tha se Jezusi ishte ai «*që e shëroi*»! Tani ai besoi te Jezusi. Kështu ai dëshmoi për fuqinë e Zotit të tij, ai gjithashtu dëshmoi në këtë mënyrë se Jezusi është Zot. Shpirti i njeriut ishte shëruar, bashkë me trupin dhe mendjen e tij.

Gjoni e mbyll tregimin me shënimin e tij: «Për këtë hebrenjtë e përndiqnin Jezusin dhe kërkonin ta vrisnin, sepse bënte këto gjëra të shtunave» (v. 16).

## JEZUSI MUND TË NA SHËROJE TË GJITHËVE

Ky është fundi i ngjarjes së shërimit të njeriut te pellgu, por ne s’kemi mbaruar me tekstin tonë. Unë dua që ne të mendojmë për një grup tjetër njerëzish që ishin të pranishëm në atë ngjarje. Më pas unë dua të nxjerr mësimin për secilin prej nesh.

### Pyetja për farisenjtë

A keni menduar ndonjëherë se Jezusi mund të kishte pyetur *udhëheqësit hebrenj*: «A doni me të vërtetë të shërohemi»? Mendoni pak: Përveç apostujve të Jezusit, kush ka parë dhe dëgjuar më shumë për mrekullitë dhe mësimet e Tij? Skribët<sup>4</sup> dhe farisenjtë! Ata ishin kritikët e Tij, që e ndoqën Jezusin kudo për ta kapur gabim, që të mund ta akuzonin. Pak më përpara se ngjarja që ne studiuam, ata ishin fshehur në fushat me grurë! Ata kishin akuzuar dishepujt e Jezusit për thyerje të ligjit të së shtunës, pasi dishepujt morën grurë dhe e hëngrën (Mateu 12:1, 2).

Këta hebrenj kishin çdo mundësi për t’u

shëruar shpirtërisht nga Jezusi. Kombi i Izraelit ishte në pritje të Mesisë për vite të tëra. Ata ishin në dijeni të profecive për Mesinë: si do të shfaqej Mesia dhe çfarë do të bënte. Jezusi përmbushi çdo profeci.

Ata thanë: «Ne duam ardhjen e Mesisë! Ne duam që Ai të shërojë kombin tonë!» Jezusi mund t’i kishte pyetur: «A jeni të sigurtë se doni të shërohemi?»

Në pjesën e fundit të kapitullit 5 të Gjonit gjendet një nga fjalimet e mëdha të Jezusit drejtuar udhëheqësve hebrenj (vargjet 19–47). Në këtë predikim, tre janë mësimet kryesore: (1) Ai ishte i barabartë me Perëndinë, (2) Ai bëri punët e Perëndisë dhe (3) Ai kishte fuqinë e Perëndisë. Ai dha jetë shpirtërore (v. 21), Ai do të ringjallë të vdekurit (vargjet 28, 29) dhe do të gjykojë të gjithë njerëzimin (vargjet 22, 23). Në këtë predikim ndodhen prova të vërteta dhe të mjaftueshme për të bindur dhe shpëtuar mijra vetë.

Jezusi mund t’i ketë pyetur ata: «A nuk doni të shërohemi nga gjithë problemet shpirtërore»? N.q.s. Ai do ta kishte bërë një pyetje të tillë, përgjigjja ndoshta do të kishte qenë: «Po ... përderisa nuk nënkupton që ne të braktisim traditat dhe paragjykimet tona». Me fjalë të tjera: «Ne duam të shërohemi, por s’duam të paguajmë asnjë çmim për të!»

### Pyetja për ne

A jemi gati t’i përgjigjemi një pyetjeje të tillë? Unë ju paralajmëroj: Nuk do të jetë e lehtë! Mund të jetë e sikletshme!

A jeni shumë i shëndoshë? A doni *me të vërtetë* të dobësoheni? Me një fjalë, a jeni gati të mbani dietë dhe të bëni gjimnastikë? (A nuk do të jetë e pakëndshme, nëse s’do të mund të hani ushqimet që çdo njeri tjetër mund të hajë për shkak të dietës?)

Mendoni pak se si shumë njerëz sot thonë: Ju nuk keni ndonjë sëmundje konkrete, por prapëseprapë ju ndiheni pa qejf. A dëshironi të ndiheni më mirë? Ju mund të hani ushqimin e nevojshëm dhe mund të bëni gjimnastikën e nevojshme, por a keni dëshirë ta rimendoni jetën tuaj dhe të zgjidhni përparësitë në jetë, që të mund të qetësoni trupin, mendjen dhe shpirtin? Pra, a jeni gati të paguani çmimin për t’u ndjerë më mirë?

A ka ndonjë njeri me të cilin ju s’mund të

pajtoheni? A dëshironi me të vërtetë të përmirësoni marrëdhëniet me atë individ? A jeni gati të paguani çmimin? A jeni gati të ulni krenarinë tuaj dhe të thoni: «Më vjen keq për çfarë ka ndodhur»? A jeni në gjendje të bëni çfarë është e drejtë, kur personi tjetër nuk bën çfarë është e drejtë? A jeni gati të mësoni të jetoni si shërbëtor?

A do t'ju pëlqente të kishit një martesë më të mirë apo një familje më të gëzuar? Ne do të thoshim «Po», por kjo do të thotë që ne të ndryshojmë ... dhe çdo ndryshim arrihet me dhembje ... dhe ne nuk duam që të provojmë dhembjen.

A ndjeheni shumë fajtor? A doni me të vërtetë të hiqni atë dhembje të brendshme? A jeni gati të përuleni përpara Perëndisë dhe t'i jepeni tërësisht dëshirës së Tij? A ndjeheni i brengosur për mëkatet tuaja dhe a jeni gati të ndryshoni mënyrën e jetës tuaj (Bibla e quan këtë «pendim»)? N.q.s. nuk jeni pagëzuar (me anë të zhytjes në ujë) për faljen e mëkateve tuaja (Veprat 2:38), a jeni gati ta merrni këtë vendim? N.q.s. jeni fëmijë i Perëndisë dhe e dini që keni mëkatuar, a jeni gati ta vendosni veten tuaj përpara mëshirës së Perëndisë (1 Gjoni 1:9)? N.q.s. veprimet tuaja kanë dëmtuar figurën tuaj, a jeni gati ta pranoni atë publikisht dhe të filloni nga e para (Jakobit 5:16)? A keni dëshirë të paguani çmimin e nevojshëm?

*Cilido* që të jetë problemi juaj, Jezusi do t'ju ndihmojë ta zgjidhni atë, n.q.s. ju do ta lejoni Atë t'ju ndihmojë. Shikoni Jezusin. *Përpiquni* të bëni atë që është e drejtë. Kur njeriu që qëndronte afër pellgut u përpoq, Jezusi i dha atij fuqinë të drejtohej dhe të ecte. Besoni te Jezusi se ai mund t'ju japë ato gjëra që ju s'mund t'i arrini vetë.

Jezusi mund të shërojë trupat, mendjet dhe shpirtrat tanë.

## KONKLUZION

Jezusi është gjithmonë më i preokupuar për shpirtin. Ai i tha njeriut: «Mos mëkato më, që të

mos të të bëhet një gjë më e keqe» (v. 14). Jezusi në këtë moment dëshiron që të shërojë shpirtrat tanë. Ai na fton që të çohemi dhe të ecim me Të. Sidoqoftë, ne mund të qëndrojmë në vend. Kur Jezusi i tha këtij njeriu: «Çohu, merre vigun tënd dhe ec», ky njeri mund të mos ngrihej. Ai e kishte në dorë. Ai mund të kishte vazhduar të qëndronte i shtrirë. Dhe në fund ai mund të kishte vdekur në kushte të tmerrshme. Kështu që, kur Jezusi na thërret, është në dorën tonë të bindemi apo jo. Mund të jetë më e përshtatshme që të qëndrojmë në krevatin tonë dhe mos të lëvizim, por, n.q.s. ne bëjmë këtë, kurrë s'do të ripërtërihemi! Vendimi është në dorën tonë.

Perëndia na ndihmoftë që të mos bëhemi si farisenjtë. Perëndia na ndimofte që të lemë mënjatë traditat dhe paragjykimet tona. Le t'i nënshtrohemi Perëndisë. Ai *do të* na shërojë!

A doni *me të vërtetë* të shëroheni? Veprimet tuaja do të tregojnë përgjigjen tuaj.

## SHËNIME

<sup>1</sup> Dikush mund të thotë: «Jezusit i pëlqente të shkonte në kishë».

<sup>2</sup> Përgjigja e njeriut tregon se qarkullonin disa hamendje rreth fuqisë shëruese të ujit kur lëvizte, siç ata besonin, nga një ëngjëll.

<sup>3</sup> «E shtuna» sipas Testamentit të Vjetër konsiderohej ditë pushimi për hebrejtë. Farisenjtë ishin kaq striktë sa nuk lejonin që të bëhej dhe puna më e vogël ditën e shtunë.

<sup>4</sup> Midis hebrejve, «skribët» ishin mësuesit më të vlerësuar dhe të dëgjuar të ligjit të Moisiut.

---

## Në këmbët e Jezusit

Kur njerëzit nderojnë Jezu Krishtin, ata nuk përulën përpara këmbëve të Tij, të nënshtuar e me zemër të thyer, por ata përulën me dashuri të plotë. Një njeri nuk thotë: «Unë s'mund t'i rezistoj një fuqie të tillë», por thotë: «Dashuria, kaq e çuditshme, kaq qiellore, kërkon jetën time, shpirtin tim, gjithçka që kam». Një njeri nuk thotë: «Unë jam i detyruar që të nënshtrohem». Por thotë: «Unë jam i humbur mes çudisë, dashurisë dhe lavdërimit ndaj Perëndisë».

William Barclay